

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXI, nr. 6518
E martë, 25 janar 2022
çmimi 0.40

Kërkohet lehtësimi i masave kundër Covidit në hyrjet e Kosovës

FAQE 7



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

OPOZITA ME REZOLUTË KËRKON TË NDALOHET RRRITJA E ÇMIMIT TË ENERGJISË

FAQE 4-5

KUVENDI I KOSOVËS KA MBAJTUR SEANCË TË JASHTËZAKONSHME PËR ÇMIMIN E ENERGJISË ELEKTRIKE



Deputetët e partive opozitare e kanë fajësuar kryeministrin Albin Kurti për shtrenjtimin e energjisë elektrike. Gjatë seancës së jashtëzakonshme, ata kanë thënë se neglizhencia e qeverisë ndaj krizës globale energjetike ka bërë që të shtrenjtohet rryma. Ata kanë kërkuar që me anë të një rezolute të parandalohet rritja e çmimit të energjisë. Kryeministri Albin Kurti ka mohuar pretendimet e opozitarëve. Ai ka arsyetuar propozimin e ZRrE-së për shtrenjtimin e rrymës, duke fajësuar qeveritë e kaluara për gjendjen e krijuar në energjetikë

OPINION

MBI EFEKTIN E SUBVENCIONEVE DHE FORMAVE TË TJERA TË NDIHMËS SHITETËRORE F. 5

Shkruan:
Elton TOTA



AKTUALE



AKTAKUZË KUNDËR 20 PERSONAVE PËR ARMË DHE FALSIFIKIM TË PARAVE F. 6

USHTARËT E FSK-SË TRAJNOHEN NGA AMERIKANËT SI TË REAGJNË NË FUSHËBETEJË F. 6

LV-ja DHE PDK-ja DO TË BASHKËQEVERISIN NË PODUJEVË F. 7

DY TË VDEKUR DHE 2 243 RASTE TË REJA ME COVID F. 7


EKONOMI



ATK-ja: NGA 1 SHKURTI DEKLARIMI I TATIMEVE DHE KONTRIBUTEVE DO TË BËHET ONLINE F. 8

BE-ja FTON KOSOVËN QË TA LIBERALIZOJË TREGUN E ENERGJISË ELEKTRIKE ME PAKICË F. 8

22 vjet me gazetën "Epoka e re" FAQE 7



DËSHMITARI: ZPS-ja S'KA NDJEKUR PRAKTIKAT MË TË MIRA TË PROCEDURAVE NË OVL-UÇK

FAQE 7

RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepçishtë - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
+389 44 487 200
E-mail: renova@mt.net.mk
Mob: +377 44 501 289

PRINCESHA
GROUP SH.PK.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
030-500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

ShBA-ja dhe Britania bëjnë lëvizjet e tyre në Ukrainë

WASHINGTON, 24 JANAR - Shtetet e Bashkuara të Amerikës (ShBA-ja) ka njoftuar të dielën në mbrëmje se do të pakësojë numrin e personelit në ambasadën në Kiev, duke nisur nga familjarët dhe anëtarët e stafit jothelbësor. Të njëjtin vendim e ka marrë edhe Mbretëria e Bashkuar, e cila ka nisur tërheqjen e stafit nga Ambasada në Ukrainë, ndërsa për momentin zyrtarët e Bashkimit Evropian kanë deklaruar se do të qëndrojnë aty. Kjo është shenja më e fundit që paralajmëron përshkallëzimin e konfliktit në Ukrainë, pasi të gjithë aktorët tashmë besojnë se Rusia mund ta nisë pushtimin e vendit fqinj. Departamenti Amerikan i Shtetit ka theksuar se vendimi është marrë pavarësisht se niveli i rrezikut për personelin e ambasadës nuk është rritur në ditët e fundmi. Por sërish vendimi ka theksuar frikën për

pushtimin rus, të cilin vetë zyrtarë amerikanë e kanë cilësuar si të mundshëm. “CNN”-i ka raportuar të premten se kërkesa kishte ardhur nga vetë ambasada për shkak se Rusia ka shtuar dhjetëra mijëra trupa në kufi me Ukrainën. Nga ana tjetër, “BBC”-ja ka raportuar se stafi në ambasadën britanike në Kiev do të përgjysmohet. Sipas Ministrisë ukrainase të Mbrojtjes, trupat ruse në kufi janë 127 mijë, por Kiev zyrtar ka thënë se vendimi për ta larguar stafin është “i parakohshëm” dhe “i tepruar”. Kurse kryediplomati i Bashkimit Evropian, Josep Borrell, ka thënë se unioni nuk do ta “dramatizonte” më tutje situatën duke tërhequr stafin. “Nuk do të marrim të njëjtin vendim, pasi nuk kemi arsye specifike për ta bërë këtë”, ka thënë Borrell para një takimi me ministrat e Jashtëm të BE-së.



OBSH-ja beson se faza akute e pandemisë mund të përfundojë këtë vit



Gjenevë, 24 janar - Faza akute e pandemisë së koronavirusit mund të përfundojë këtë vit nëse shtetet përdorin të gjitha mjetet që kanë në dispozicion, ka thënë të hënën shefi i Organizatës Botërore të Shëndetësisë (OBSH), Tedros Adhanom Ghebreyesus. Ai i ka thënë komitetit ekzekutiv të OBSH-së, se qëllimi mund të arrihet nëse rritet shkalla e vaksinimit në vendet e varfra dhe kryhen më shumë testime. “Nëse shtetet shfrytëzojnë të gjitha strategjitë dhe mjetet në mënyrë gjithëpërfshirëse, ato mund t’i japin fund fazës akute të

pandemisë këtë vit. Ne mund t’i japim fund Covid-19 si emergjencë globale shëndetësore dhe mund ta bëjmë këtë gjatë këtij viti”, ka thënë ai. Ai u ka thënë ministrave të shëndetësisë dhe zyrtarëve nga 34 shtete se tanimë është tejkaluar mungesa e vaksinave dhe sfida logjistike përbën procesi i dërgimit të dozave në të gjitha kombet. Megjithatë, shefi i OBSH-së ka bërë thirrje për kujdes. Ai ka thënë se përhapja e shpejtë e variantit “Omicron” të koronavirusit nënkupton se 100 raste të reja janë raportuar çdo tre sekonda në

OBSH javën e kaluar. Një vdekje është raportuar çdo 12 sekonda. “Është e rrezikshme të deklarojmë se Omicron do të jetë varianti i fundit dhe se jemi në fund të luftës”, ka thënë ai. Sipas tij, 85 për qind e popullsisë në Afrikë nuk e ka marrë asnjë dozë të vaksinës kundër koronavirusit. Nëse 70 për qind e popullsisë së secilit shtet vaksinohet në muajt e ardhshëm, virusi mund të mposhtet, ka shtuar Tedros. Ai ka thënë se trajtimet për këtë virus duhet të përmirësohen në mënyrë që të zvogëlohet shkalla e vdekshmërisë.

Kina sërish dërgon avionë luftarakë drejt Tajvanit

TAIPEI CITY, 24 JANAR - Tridhjetë e nëntë avionë luftarakë të Kinës kanë fluturuar drejt Tajvanit në kohën kur tensionet mbi të ardhmen e këtij ishulli janë rritur. Në mesin e avionëve që fluturuan të dielën mbi Tajvan kishte edhe avionë luftarakë të tipit “J-16” dhe “J-10”, ka njoftuar Ministria e Mbrojtjes e Tajvanit. Forcat ajrore të Tajvanit thanë se ngritën në qiell avionët e tyre për t’o gjurmuar avionët kinezë. Avionët e Kinës, po ashtu, janë detektuar edhe në radarë, ka njoftuar kjo ministri. Dërgimi i avionëve kinezë drejt Tajvanit ka ndodhur pasi

ushtria amerikane ka bërë me dije se dy grupe të saj të luftanijeve kanë lundruar të dielën në Detin Jugor të Kinës. ShBA-ja ka theksuar se luftanijet “USS Carl Vinson” dhe “USS Abraham Lincoln” janë angazhuar në operacione për sulme nga nëndetëset dhe ato ajrore si dhe ishin në gatishmëri. Ky është numri më i madh i avionëve që Kina ka nisur gjatë këtij viti drejt Tajvanit. Tajvani dhe Kina kishin zhvilluar një luftë civile më 1949 dhe Kina pretendon se ky ishull është territor i saj. Pekini ka përdorur rrugë diplomatike dhe ushtarake për ta izoluar ishullin dhe frikësuar

autoritetet e këtij ishulli, por ShBA-ja ka vazhduar ta mbështesë Tajvanin, duke i shitur armë të avancuara dhe avionë luftarakë. Që më shumë se një vit pilotët kinezë fluturojnë drejt Tajvanit pothuajse çdo ditë. Në tetorin e vitit të kaluar brenda një dite Kina dërgoi 56 avionë luftarakë drejt Tajvanit. Tensionet janë rritur që prej se tajvanezët më 2016 zgjodhën në postin e presidentes, Tsai Ing-wen. Pekini u përgjigj duke ndërprerë komunikimet me Qeverinë e Tajvanit. Paraardhësi i Tsait ishte i afërt me Kinën dhe Pekini pretendon se të dy shtetet janë pjesë e kombit kinez.



Dëshmitari: ZPS-ja s'ka ndjekur praktikat më të mira të procedurave në OVL-UÇK

HAGË, 24 JANAR - Dëshmitari ekspert, Robert Reid, i cili ka dëshmuar të hënën në gjykimin ndaj udhëheqësve të Organizatës së Veteranëve të Luftës së UÇK-së në Hagë, ka thënë se Zyra e Prokurorit të Specializuar (ZPS) nuk ka ndjekur praktikat më të mira të procedurave gjatë operacioneve në zyrat e organizatës në shtator të vitit 2020. Reid, i cili ka qenë shef i operacioneve në Zyrën e Prokurorit të Tribunalit Penal Ndërkombëtar për ish-Jugosllavi (TPNJ), ka thënë se në rastin OVL-UÇK, prokuroria nuk i ka ndjekur udhëzimet e punës që janë përdorur në tribunalin ndërkombëtar.

Reid është dëshmitar ekspert i mbrojtjes së Nasim Haradinajt dhe ai është përgjigjur në pyetjet e avokatit Toby Cadman.

Camdan e ka pyetur atë për operacionet e ZPS-së më 8, 17 dhe 22 shtator në zyrën e OVL-UÇK. Sipas dëshmitarit, këto operacione nuk janë kryer mbështetur në standardet e duhura dhe efektive. "Jo, unë nuk besoj që ata kana ndjekur praktikat më të mira të procedurave. Nuk mendoj që ata kanë ndjekur standardet, procedurat dhe udhëzimet e standardet e punës që ne kemi përdorur në TPNJ", ka thënë dëshmitari ekspert.

Dokumentet që i ka parë Reid ka thënë se nuk janë të përpunuara sipas zinxhirit të ruajtjes, ndërsa prokuroria ka kundërshtuar pyetjet që lidheshin me rrjedhjen e dokumenteve.

Ai ka thënë se duhet të ekzistojë dokumentacion i tërësishëm i hetuesit i cili i ka koordinuar kontrollin dhe sekuestrimin. "Po, duhet të ekzistojë dokumentacion i tërësishëm i këtij hetuesi, i kryehetuesit së pari, një dokument që të kërkonte leje që misioni të bëhej", ka thënë ai.

Reid ka bërë me dije se fusha e specializimit të tij janë hetimet penale, duke theksuar se është ish-officer policor dhe prej vitit 1994 deri në vitin 2018 ka punuar në TPNJ. "Zinxhiri komandues është shumë i



thjeshtë, bazik, porsa dokumentet vijnë në dorën tënde duhet të jesh në dijeni se ku janë në çdo minutë të ditës dhe shtatë ditëve të javës, dhe këtë bënim kur shkonim në mision. Kishim një punonjës që merrej me dëshmitë, me provat dhe kur një grup dokumentesh merreshin ai regjistronte, ai nuk regjistronte çdo faqe të veçantë dhe çdo dokument, por një dosje që ka titullin X Y, pastaj sigurohej që ajo dosje të shkonte në kutinë e provave që i vihej një numër. Pastaj këtë numër ai e shënonte në bllokun e inventarit dhe ishim në gjendje të thoshim me saktësi se çfarë dokumentesh përmbante çdo qese", ka thënë dëshmitari.

Ndër të tjera, avokati e ka pyetur atë rreth përvojës së tij të vitit 1997 në Prijedor dhe në Banjalukë, ku Reid ka treguar mënyrën se si barteshin dhe ruheshin dokumentet. "E di që ishte një proces shumë i madh, me përkthyes, ne të gjithë që

shikonim të gjitha dokumentet për të bërë një inventar të hollësishëm, jo faqe për faqe, por për t'u dhënë autoriteteve një ide të përgjithshme të asaj që kishim marrë. Pasi bëhej kjo punë dhe u jepej autoriteteve gjithçka vulosej prapë dhe dërgohej me sigurinë ushtarake, shoqëruar me ushtri, në Zagreb dhe futej në një dhomë që edhe ajo vulosej. Jam shumë i sigurt, edhe pse jo 100 për qind, por një punonjës i sigurisë rrinte në zyrë atë natë për t'i ruajtur dokumentet dhe të nesërmen një nga shefat e ekipit hetues dhe shoferi i sillnin ato në Hagë, ku dokumentacioni i jepej sipas zinxhirit ruajtës njësisë së provave. Jam i sigurt i jepeshin shefit të kësaj njësie", ka thënë ai. Ai ka treguar edhe procedurat që ndiqeshin kur kamioni me dokumente arrinte në Hagë. "Kur vinte kamioni këtu, unë e takoja bashkë me njësinë e provave, i shkarkonim kutitë në TPNJ, kishim dy zyra të mëdha

poshtë nën tokë ku i mbanim këto dokumente, të gjitha i vendosim aty. Pastaj, njësia e provave nënshkruante dhe ndiqej zinxhiri i ruajtjes, pastaj dokumentacioni merrej në ruajtjen e tyre ne si hetues, juristë, përkthyes të tjerë e kishim bërë punën tonë, tani e kishte radhën njësia e provave të bënte punën e saj, e vetmja gjë që do të bënim më shumë, nuk e di nëse e kemi bërë në '97-n, nuk e di nëse kishim mjete elektronike apo kishim dokumente në letra, sepse njësia e provave kërkonte të kishim disa metoda. Gjithsesi dikush i vendoste metodat që shpjegonin çfarë dokumentesh ishin, data që ishin marrë, autorët që kishin përgatitur e të tjera", ka thënë Reid.

Avoakti Cadman e ka pyetur atë rreth deklaratave të dëshmitares së ZPS-së, Zdenka Pumper, e cila kishte thënë se udhëzimet për çështjen OVL-UÇK i kishte marrë gojarisht nga prokuroria

dhe nuk kishte mbajtur shënime. "Ne merrnim një kërkesë nga personi që do ta kryesonte misionin dhe gjithmonë procedurat, standardet e punës siguronin, garantonin që puna të bëhej e njëjtë për të gjithë në këtë rast i drejtohemish zëvendësprokurorit të shefi i hetimeve, komanda e hetimeve, për shembull, nëse unë kam qenë përgjegjës për hetimin e autorëve myslimanë dhe u morëm me ushtrinë e Bosnjës, duhet të siguroheshe që të merreshin të gjitha masat që ushtria të ishte e informuar plotësisht dhe të përfshihej", ka thënë dëshmitari.

Reid ka thënë se aktualisht është në pension dhe puna e fundit që ka bërë ka qenë nga tetori i vitit 2019 deri në shtator 2020 dhe ka qenë për mekanizmin ndërkombëtar për tribunalet kombëtare dhe prokurorin Broomers që punon në gjykatën e Ruandës. /KSP/

22 vjet me gazetën "Epoka e re"



PRISHTINË, 24 JANAR (ER) - Gazeta e përditshme "Epoka e re" është themeluar më 15 dhjetor 1999, por numri i saj i parë ka dalë më 25 janar 2000. Sot (e martë) "Epoka e re" ka mbushur 22 vjet që nga numri i parë. Në këto vite gazeta ka pasur edhe sfida, disa të rënda e disa të lehta, por deri më sot i ka kaluar të gjitha me sukses. "Epoka e re" botohet online dhe në formatin PDF. Në

formatin PDF sot është botuar numri i 6 508.

Botues i gazetës "Epoka e re" është Muhamet Mavraj, personalitet i njohur i demonstratave studentore të vitit 1997. "Epoka e re" shquhet për kuadrin e saj kritik gazetaresk, i cili synon arritjen e një informacioni të ri në mjedisin shqiptar dhe formësimin e audiencës kritike.



KUVENDI I KOSOVËS KA MBAJTUR SEANCË TË JASHTËZAKONSHME PËR ÇMIMIN E ENERGJISË ELEKTRIKE

Opozita me rezolutë përpiqet ta parandalojë rritjen e çmimit të energjisë

Deputetët e partive opozitare e kanë fajësuar kryeministrin Albin Kurti për shtrenjtimin e energjisë elektrike. Gjatë seancës së jashtëzakonshme ata kanë thënë se neglizhenca e qeverisë ndaj krizës globale energjetike ka bërë që të shtrenjtohet rryma. Ata kanë kërkuar që me anë të një rezolute të parandalohet rritja e çmimit të energjisë. Kryeministri Albin Kurti ka mohuar pretendimet e opozitarëve. Ai e ka arsyetuar propozimin e ZRrE-së për shtrenjtimin e rrymës, duke fajësuar qeveritë e kaluara për gjendjen e krijuar në energjetikë

**EPOKA
ERE**

Muhamet KOCI

PRISHTINË, 24 JANAR - Pozita dhe opozita janë përplasur të hënën në Kuvendin e Kosovës rreth rritjes së çmimit të energjisë elektrike. Në seancën e jashtëzakonshme, e cila është thirrur nga opozita, deputetët e PDK-së, të LDK-së dhe të AAK-së kanë fajësuar drejtpërdrejt kryeministrin Albin Kurti, ndërsa ky i fundit ka arsyetuar propozimin për shtrenjtimin e rrymës.

Shefi i grupit parlamentar i PDK-së, Abelard Tahiri, gjatë prezantimit të çështjes për

diskutim, ka thënë se qeveria është treguar e paaftë për t'u ballafaquar me krizën energjetike. "Kur vendet e rajonit tonë dhe shtetet e Bashkimit Evropian filluan që të merrnin masa për ta mënjanuar krizën e paralajmëruar energjetike, qeveria jonë qëndroi neglizhente dhe edhe sot e kësaj dite nuk mund ta kuptoj indiferencën të cilën e tregoi gjatë atyre muajve", ka thënë Tahiri, duke treguar se si e kuptoi qeveria krizën energjetike.

"Fillimisht u dashtë me u ndal rryma që me udhëheq qeveria jonë. Kur u dhez qeveria, u dhez

edhe kryeministri Kurti, KEDS-i, KEK-u, ZRrE-ja e kush jo dhe na dhanë dy alternativa: E para, shtrenjtimi 100 për qind i energjisë; dhe, e dyta, reduktime sikur pas luftës, 8 me 2, 8 me 4 e kështu me radhë", ka thënë Tahiri.

Tahiri i ka ftuar deputetët që në fund të debatit të miratojnë një rezolutë të harmonizuar nga të gjitha grupet parlamentare që të parandalohet rritja e çmimit të energjisë elektrike.

Kritika për kryeministrin ka pasur edhe kryetari i LDK-së, Lumir Abdixhiku. "Kemi mbledhur 40 nënshkrime sepse ndajmë besimin me të gjithë qytetarët tanë se paralajmërimi për shtrenjtim të energjisë elektrike, në formatin e bërë, është i papërbalueshëm, është i padrejtë dhe, mbi të gjitha, është diskriminues dhe dënues ndaj një grupi të caktuar shoqëror prandaj, si i tillë, duhet të refuzohet nga ky Kuvend. Ky debat i sotëm duhet parë si vazhdimësi e debatit parlamentar të 28 dhjetorit të vitit të shkuar, kur Kosova në vonesën më të pashpjegueshme reaktive, kishte nisur krejt e

fundit debatin publik për krizën energjetike", ka deklaruar Abdixhiku. Sipas tij, nëse qeveria do të reagoje me kohë, Kosova nuk do të ishte në këtë gjendje. "E kishte nisur me tre muaj vonesë nga vendet e rajonit, e me plot gjashtë muaj vonesë nga vendet e tjera evropiane. Dhe meqë ishte e fundit në debat, ishte natyrshëm dhe e fundit në reagim. Sepse institucionet e Kosovës, Qeveria e Kosovës, në vazhdimësi kishin mohuar se kishte krizë. Këtë mohim krize e kishin pasur me mosveprim, vetëm për të përfunduar me paralajmërimin e javës që shkoi, se nga muaji i ardhshëm çmimet e energjisë elektrike do të rriteshin në shkallë rekorde për qytetarët tanë, më të lartën në historinë e Kosovës", ka deklaruar Abdixhiku.

Kurse kryetari i AAK-së, Ramush Haradinaj, ka thënë se kryeministri Kurti duhet të marrë përgjegjësi ose duhet të ikë në shtëpi. "Ky zotëri atë ditë që s'ka mundur ta zbresë çmimin e energjisë është dashur me thënë: 'më falni'. Tash ky është dashur me i dërguar në shpi krejt ekipin ekonomik që e

ka këtu, ja të marrë përgjegjësinë vetë, ja të shkojë në shpi Albin Kurti! Njërin duhet ta bëjë. Nuk i ka dërguar m'u mërdhi me kohë. Nuk i ka dërguar të punojnë dhe vjen këtu na jep leksione", ka deklaruar Haradinaj.

Më tutje, Haradinaj ia ka kujtuar Kurtit qëndrimet sa ishte në opozitë, i cili kërkonte lirim të energjisë elektrike. "Kurti është kryetar i qeverisë dhe ka kërkuar besimin e qytetarëve me ul çmimin e energjisë. Ka kërkuar votë dhe ka bind njerëzit me ia ul çmimin. S'po ulet çmimi. Ky zotëri që s'ka mundur me ul çmimin e energjisë është dashur t'i kërkojë falje popullit dhe me dërgua ekipin e ekonomisë në shpi. Një qeveri normale kur dështon në një qëllim i kërkon llogari dikujt. Po rrinë në zyrë dhe po lexon. E ke ditë kur ke refuzuar gazin. Edhe mua ma kanë sjellë propozim për ngritje të çmimit të energjisë. U kam thënë jo. Kjo situatë na duket qesharake por, kryeministër, fajin je duke ua gjuajtur qytetarëve. Veç defin me rrokë, se tjetër gjë s'u ka mbetë deputetëve tuaj", ka thënë Haradinaj.

Mustafa thotë se “Bilfinger” nuk ishte serioz

Ish-kryeministri i Kosovës, Isa Mustafa, ka reaguar për projektin e kompanisë gjermane “Bilfinger”, e cila në vitin 2015 ishte ofruar për rindërtimin e “Kosova A”. Në “Facebook” ai ka shkruar se kjo kompani kishte

ofruar vetëm 15-20 faqe “PowerPoint” për ndërtimin e këtij termocentrali. “Është e vërtetë se në takimin tim si kryeministër me kancelaren Merkel, më 30 qershor 2015, ndër çështjet e rëndësishme

shtroi edhe rindërtimin e ‘Kosovës A’ përmes firmës ‘Bilfinger’. Unë shpreha gatishmërinë e plotë ta zhvillojmë këtë projekt. Me angazhimin e kancelares, të njëjtën ditë, në orët e mbrëmjes,

kemi organizuar takim me përfaqësuesit e Bilfinger në Berlin. Kemi kërkuar ta konkretizojnë propozimin e tyre, koston e investimit, kapacitetin dhe burimet e financimit. Përfaqësuesit e

‘Bilfinger’ u zotuan se do të na informojnë brenda 15 ditëve, por nuk na kanë informuar asnjëherë edhe përkundër insistimit të vazhdueshëm të kabinetit tim”, ka shkruar Mustafa.



Kurti sërish arsyeton rritjen e çmimit të rrymës

Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka mohuar kritikën e deputetëve opozitarë. Ai ka thënë se problemet e trashëguara kanë kulmuar në krizën energjetike me të cilën po përballen qytetarët. Sipas tij, fajet për këtë gjendje i kanë edhe qeveritë e kaluara. “Dy probleme kryesore të dekadës së fundit. I pari është ai i 17 tetorit të vitit 2012: vendim për shitjen e aksioneve të Kompanisë së Shpërndarjes dhe Furnizimit të Energjisë

Elektrike. Nuk do të ndodheshim në këtë situatë sikurse të mos e kishim një monopol privat në këtë fushë. Dhe kemi pasur një shitje prej 26.3 milionë eurove të kompanisë me vlerë shumëfish më të madhe. Dhe data tjetër, 31 mars 2017: ndryshimi i strukturës tarifore, heqja e bllok-tarifës. Konsumatorët me konsum më të ulët subvencionojnë konsumatorët me konsum më të lartë. Këto dy janë probleme kapitale që i kemi trashëguar sot”, ka deklaruar Kurti.

Sipas kryeministrit Kurti, nuk ka zgjidhje ideale në një krizë të thellë e të shkaktuar ndër shumë vite. “Unë nuk jam për

reduktim të energjisë elektrike. Nëse nuk duam reduktim, atëherë duhet ta kuptojmë se ose duhet të kemi subvencionim nga shteti ose shtrenjtim të energjisë ose kombinim të këtyre të dyjave, për ta gjetur njëfarë mesazhi të artë në një situatë ku nuk ka zgjidhje të mirë. Nuk ka mundësi të tjera”, ka deklaruar Kurti. Madje, sipas Kurtit, aq lirë ka qenë çmimi i energjisë saqë qytetarët nuk e kanë ditur sa e kanë faturën. “Në historinë e Kosovës numër më të madh të qytetarëve që nuk e kanë ditur se sa e kanë faturën nuk ka pasur ndonjëherë”, ka thënë Kurti.

Edhe ministrja e Ekonomisë,

Artane Rizvanolli, ka thënë se Kosova si shtet nuk ka kapacitete të mjaftueshme për të prodhuar energji elektrike që konsumohet, sidomos gjatë dimrit dhe çmimit të lartë të importit. “Që nga viti 2017 kur është hequr bllok tarifa, ne konsumojmë më shumë energji elektrike vit pas viti. Ne si shtet nuk kemi kapacitete të mjaftueshme për të prodhuar energjinë që konsumojmë, sidomos gjatë dimrit ne varem nga importi. Gjatë muajit dhjetor, janar e deri tani kemi importuar rreth 10 për qind të energjisë. Evropa, tani edhe Kosova, po përballen me një krizë të jashtëzakonshme. Varësia jonë

nga importi nuk ka qenë problem derisa çmimet kanë qenë 6 deri 9 centë për kWh. Sistemi ynë energjetik është pranë kolapsit. Nga këto dallime në çmimin e blerjes dhe shitjes janë akumuluar rreth 100 milionë euro borxhe në sistem”, ka thënë Rizvanolli.

Zyra e Rregullatorit të Energjisë (ZRRE) ka propozuar rritje të çmimeve të energjisë për amvisëritë për 9 për qind. Qeveria ka thënë se ka ndarë 75 milionë euro që të subvencionojnë një pjesë të faturave të energjisë.

Votimi i rezolutës se propozuar nga opozita është shtyrë për nesër (e mërkurë) për shkak të mungesës së kourumit.

Molliqaj: KEDS-i i ka kushtuar Kosovës mbi 200 milionë euro

Kryetari i PSD-së, Dardan Molliqaj, ka bërë me dije se kompania KEDS po i zvat taksat e qytetarëve të Kosovës duke marrë miliona euro nga buxheti i Kosovës dhe KEK-u. Në profilin e vet në “Facebook”, ai ka shkruar se KESCO dhe KEDS në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe të tërthortë i

kanë kushtuar buxhetit të Kosovës mbi 200 milionë euro. “Nëse i mbledhim së bashku 44.5 milionë eurot e subvencionuara nga Qeveria e Kosovës, me 75 milionë euro të tjera për të cilat është zotuar Qeveria e Kosovës me aprovimin e raportit të ZRRE-së, me dallimin në çmim që do ta

paguajmë ne si qytetarë dhe borxhin që kompania ua ka kompanive publike KEK dhe KOSTT, atëherë mund të themi që KESCO dhe KEDS i kanë kushtuar Kosovës, në mënyrë direkte dhe indirekte, mbi 200 milionë euro të cilat kanë shkruar për t’i mbuluar humbjet e tyre”, ka shkruar Molliqaj.



LV-ja dhe PDK-ja do të bashkëqeverisin në Podujevë

PODUJEVË, 24 JANAR (ER) - Pas Gjilanit, Lëvizja Vetëvendosje dhe PDK-ja kanë arritur marrëveshje për bashkëqeverisje në komunën e Podujevës. Sipas kësaj marrëveshje, PDK-ja në Podujevë, përpos kryesuesit të Kuvendit Komunal, do t'i drejtojë edhe dy drejtori, atë të Administratës dhe të Bujqësisë. Me këtë rast, kryetari i

Podujevës, Shpejtim Bulliqi, ka thënë se me PDK-në kanë gjetur mirëkuptim për të bashkëqeverisur në katër vitet e ardhshme. "Me qëllim të funksionalizimit dhe konsolidimit të legjislativit dhe ekzekutivit të komunës, ne i kemi përfshirë dy drejtorë që vijnë nga radhët e PDK-së dhe e kemi votuar edhe kandidatin e



tyre për kryesues Kuvendi. Duke qenë të vetëdijshëm për mungesën e numrave në Kuvendin Komunal dhe përgjegjësisë që na

obligon si parti fituese e zgjedhjeve dhe mirëkuptimit që kemi hasur te grupi i këshilltarëve të PDK-së, kemi bërë më të mirën e

mundshme që ta vazhdojmë qeverisjen e mirë në katër vitet e ardhshme", ka shkruar Bulliqi në llogarinë e vet në "Facebook".

EKZEKUTIVI I KOMUNËS SË PODUJEVËS

Nënkryetare e komunës së Podujevës, Marigona Lahu
Drejtoreshë e Drejtorisë së Administratës, Antoneta Ejupi
Drejtor i Drejtorisë për Buxhet dhe Financa, Fatlum Osmani
Drejtor i Drejtorisë së Arsimit, Avni Fetahu
Drejtor i Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, Driton Veliu
Drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim, Bahri Selimi
Drejtoreshë e Drejtorisë së Pronë, Kadastër dhe Gjeodezi, Bahrie Shatrolli-Mehmeti
Drejtor i Drejtorisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Fatmir Rudari
Drejtor i Drejtorisë së Inspeksionit, Besnik Mulliqi
Drejtor i Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport, Pajtim Balaj
Drejtor i Drejtorisë për Planifikim dhe Zhvillim Ekonomik, Vigan Salihu
Ekzekutivi i Podujevës së shpejti do të plotësohet edhe me drejtorin e Drejtorisë për Planifikim Urban dhe Mbrojtje të Mjedisit.

Ushtarët e FSK-së trajnohen nga amerikanët si të reagojnë në fushëbetejë

PRISHTINË, 24 JANAR (ER) - Ushtarët e Forcës së Sigurisë së Kosovës kanë realizuar trajnimin "Reaguesi i parë në fushëbetejë", i mundësuar nga ekipi i instruktorëve amerikanë. FSK-ja ka njoftuar se pjesëtarët e saj po trajnohen si të reagojnë në fushëbetejë, duke shtuar se pjesëmarrës në këtë trajnim ishte një togë e kompanisë "2A" të Regjimentit të Dytë të Këmbësorisë. "Një ndër objektivat e Forcës së Sigurisë së

Kosovës është shkollimi dhe trajnimi i pjesëtarëve të saj, me qëllim të mbajtjes së nivelit të gatishmërisë si dhe avancimit dhe ngritjes profesionale në të gjitha fushat. Në vazhden e trajnimeve këtë herë ekipi i instruktorëve amerikanë mundësoi realizimin e trajnimit 'Reaguesi i parë në fushëbetejë' ku pjesëmarrës ishin një togë e kompanisë '2A' të Regjimentit të Dytë të Këmbësorisë. Gjatë realizimit të këtij trajnimi

pjesëtarët e Forcës së Sigurisë së Kosovës, përveç që përfituan në aspektin e njohurive dhe përvojave të reja sa iu përket reaguesve të parë në fushëbetejë, ata përfituan edhe përvoja sa i përket ndërveprueshmërisë me partnerët. Në ambientet e kazermës 'Ushtarët e NATO-s' në Istog u organizua ceremonia e certifikimit për të gjithë pjesëtarët që arritën ta përfundojnë me sukses trajnimin", ka njoftuar FSK-ja.



Aktakuzë kundër 20 personave për armë dhe falsifikim të parave



PRISHTINË, 24 JANAR (ER) - Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës (PSRK) ka ngritur aktakuzë në Gjykatën Themelore në Prishtinë - Departamentin Special, kundër 20 personave për vepra të ndryshme penale. "Prokuroria Speciale njofton

opinionin se të pandehurit me inicialet S. R., I. R., B. M., S. K., F. P., P. M., A. C., A. F., K. S., B. H., H. A., B. B., H. N., S. A., S. N., T. R., F. A. dhe A. M. akuzohen se kanë kryer veprat penale 'Importi, eksporti, furnizimi, transportimi, prodhimi, këmbimi,

ndërmjetësimi ose shitja e paautorizuar e armëve' nga neni 364, paragrafi 2, lidhur me paragrafin 1, lidhur me nenin 31-të KPRK-së", ka njoftuar PSRK-ja. Ndërsa i pandehuri me inicialet I. R. akuzohet se ka kryer veprën

penale "Falsifikimi i parasë" nga neni 296, paragrafi 2 i KPR-së. Gjithashtu, i pandehuri me inicialet S. K. akuzohet se ka kryer veprën penale "Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim i paautorizuar të armëve" nga neni 366, paragrafi 1 i KPR-së.

Mbyllen tri shkolla në Skenderaj, shkak rastet me Covid

SKENDERAJ, 24 JANAR (ER) - Komuna e Skenderajt ka bërë me dije se pas mbylljes së çerdhes "Nëna Zahide" për shkak të rasteve me Covid janë mbyllur edhe tri shkolla. Kjo komunë ka njoftuar se mësimi në këto shkolla do të zhvillohet "online". "Për shkak të numrit në rritje të të infektuarve me Covid-19,

përveç Institucionit Parashkollor 'Nëna Zahide', që u mbyll javën e kaluar, për shkak se një pjesë e stafit udhëheqës dhe edukatorëve kanë rezultuar pozitivë, sipas vlerësimit të Task Forcës në nivel shkolle, janë mbyllur edhe shkollat e mesme: Gjimnazi 'Hamëz Jashari' dhe ShMLP 'Anton Çetta' Skenderaj, ndërsa në

ShFMU 'Ahmet Delia', niveli i mesëm i ulët do ta zhvillojë mësimin 'online' sipas skenarit C. Drejtorja e Arsimit ka njoftuar se ka bërë të gjitha përgatitjet e nevojshme që procesi mësimor të zhvillohet në platformën 'online' derisa gjendja të kthehet në normalitet", ka njoftuar komuna e Skenderajt.



Kërkohet lehtësimi i masave kundër Covidit në hyrjet e Kosovës



Vendimi i Qeverisë së Kosovës, që qytetarët që hyjnë në Kosovë duhet t'i kenë tri dozat e vaksinës kundër Covidit apo dy doza dhe testin PCR negativ, ka nxitur reagime të shumta të zyrtarëve dhe qytetarëve të vendeve fqinje të Kosovës. Ata kanë kërkuar nga institucionet e Kosovës që ta rishqyrtojnë këtë masë. Sipas tyre, kjo është duke pamundësuar lëvizjen e qytetarëve të tyre. Ministria e Shëndetësisë ka dhënë sqarime për vendimin, duke thënë se ai mund të ndryshohet nëse situata epidemiologjike përmirësohet

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 24 JANAR - Shqiptarët që jetojnë në vendet fqinje të Kosovës kanë reaguar ndaj masave shtrënguese kundër Covidit që ka vendosur Kosova në pikat e saj kufitare.

Vendimi i Qeverisë së Kosovës, që qytetarët që hyjnë në Kosovë duhet t'i kenë tri dozat e vaksinës kundër Covidit apo dy doza dhe testin PCR negativ, është duke u vlerësuar si jo i drejt nga vendet që e rrethojnë Kosovën.

Të parët që kanë kundërshtuar këtë masë kanë qenë shqiptarët e Luginës së Preshevës, duke thënë se kjo masë po e pengon qarkullimin e tyre. Përfaqësuesit politikë të Luginës edhe zyrtarisht kanë kërkuar nga Qeveria e Kosovës ta rishqyrtojë këtë masë.

Kryetari i komunës së Bujanocit, Nagip Arifi, i ka shkruar kryeministrit të Kosovës, Albin

Kurti. Në letrën dërguar Kurtit ai ka shkruar se obligimi për vaksinë me dozën e tretë, apo edhe ata që janë vaksinuar me dozën e dytë dhe testi PCR, po e pamundëson lëvizjen e qytetarëve të Luginës së Preshevës. "Mbesim me shpresë se vendimi do të rishikohet, gjithnjë duke gjetur një zgjidhje që nuk rrezikon shëndetin e qytetarëve", ka shkruar Arifi në letrën e tij.

Të njëjtën gjë e ka kërkuar edhe kryetarja e komunës së Preshevës, Ardita Sinani. "Duke qenë se një pjesë jo e paktë e tyre nuk mund ta marrin dozën e tretë sepse nuk kanë kaluar mjaftueshëm muaj nga doza e dytë dhe shumë prej bashkëvendësve tanë nuk kanë mundësitë financiare për ta kryer testin RT-PCR çdo herë që e kalojnë kufirin, kjo masë po e kufizon lirinë e lëvizjes midis komunës sonë dhe Republikës së Kosovës, ku edhe punojnë, studiojnë, shërohen, apo edhe

vizitojnë reciprokisht familjarët e tyre etj.", ka shkruar Arifi në "Facebook".

I befashuar me këtë masë të Qeverisë së Kosovës është shprehur edhe zëvendëskryeministri i parë i Maqedonisë së Veriut, Artan Grubi.

"Vendimi i fundit i autoriteteve shëndetësore të Kosovës na befashoi dhe nuk e kuptoj arsyen për një masë të tillë, sepse situata shëndetësore është e njëjtë si në Kosovë dhe në Maqedoni të Veriut apo edhe në Shqipëri, ndërsa OBSH dhe vendet perëndimore po shqyrtojnë largimin e kufizimeve", ka deklaruar ai.

Edhe kryetari i AAK-së, Ramush Haradinaj, ka kritikuar vendimin e Qeverisë së Kosovës për ndalimin në kufi të qytetarëve që nuk i kanë marrë tri vaksinat kundër Covidit. "Vendim arbitrar e i dëmshëm ndalimi në kufi i qytetarëve që nuk i kanë tri vaksinat. Me këtë vendim

bllokohen kryesisht shqiptarët. Këtë masë nuk e ka aplikuar asnjëri nga shtetet fqinje. Ky është gabim i rëndë i qeverisë, që nuk mund të arsyetohet me asgjë. Prandaj hiqe bllokadën Kryeministër!", ka shkruar Haradinaj në "Facebook".

MSh-ja nuk e ndryshon vendimin

Pas reagimeve të shumta ndaj kësaj mase, Ministria e Shëndetësisë (MSh) ka dalë me sqarim lidhur me masat që i ka marrë më 22 janar. Në sqarim është thënë se vendimi nuk thotë që qytetarët gjithsesi duhet të jenë të vaksinuar tri herë, por mund të jenë me dy doza dhe dëshmi të testit negativ PCR në 48 orët e fundit. "Vendimi nuk kërkon domosdoshmërisht dëshminë e vaksinimit me tri doza të vaksinës për të hyrë në Kosovë, duke pasur gjithashtu mundësinë e hyrjes me dy doza

bashkë me praninë e testit negativ RT-PCR jo më të vjetër se 48 orë, rregull që është praktikuar edhe nga shtete të tjera. Vendimi parasheh lehtësim për ata me tri doza të vaksinës për shkak të rrezikut dukshëm më të ulët për t'u infektuar, derisa shtetasit e Republikës së Kosovës mund të hyjnë në vend duke qenë të vaksinuar vetëm me dy doza, pa pasur nevojën e prezantimit të testit negativ RT-PCR dhe, po ashtu, edhe nëse nuk i kanë dy doza të vaksinës, por duke iu nënshtruar karantinimit shtëpiak për një periudhë prej shtatë ditësh që nga hyrja në territorin e Republikës së Kosovës", është thënë në sqarimin e MSh-së.

Kjo ministri ka treguar edhe kohën se kur mund të ndryshohet kjo masë. "Mekanizmat kundër Covid-19 do të monitorojnë në baza ditore situatën epidemiologjike lidhur me Covid-19 dhe deri në fundin e javës institucionet tona do të mund të kenë një pasqyrë më gjithëpërfshirëse se cili ka qenë ndikimi i rritjes së rasteve të Covid-19 në ngarkesën spitalore dhe në varësi të kësaj, si dhe të numrit të rasteve të reja gjatë ditëve në vijim, të gjitha masat do të mund të rishikohen", është thënë në sqarimin e MSh-së.

Kuksianët protestojnë në Morinë

Qytetarët e Kukësit të hënë kanë protestuar në mënyrë paqësore në pikën kufitare në Morinë. Kjo protestë është thirrur me qëllim të heqjes së pengesës për lëvizje të lirë të shtetasve shqiptarë, të cilët nuk janë të vaksinuar me të tri dozat e vaksinës kundër Covid-19, siç e parasheh vendimi i Qeverisë së Kosovës, që askush nuk mund të hyjë në Kosovë pa pasur dëshminë e vaksinimit me të tria dozat e vaksinës.

Dy të vdekur dhe 2 243 raste të reja me Covid

PRISHTINË, 24 JANAR (ER) - Ministria e Shëndetësisë (MSh) ka njoftuar se gjatë 24 orëve të fundit kanë vdekur dy persona nga Covidi dhe janë paraqitur 2 243 raste të reja me Covid. Po ashtu, kjo ministri ka njoftuar se gjatë kësaj periudhe kohore janë dhënë 1 861 doza të

vaksinës kundër Covidit. "Prej fillimit të vaksinimit në të gjitha qytetet e Kosovës janë dhënë 1 747 841 doza të vaksinës. Deri më sot 801 524 qytetarë janë vaksinuar me dozën e dytë. Deri më sot janë dhënë 44 143 doza përforcuese dhe 12 200 doza të treta të vaksinës

kundër Covid-19. Nga 8 416 testime, 2 243 qytetarë kanë rezultuar pozitivë me virusin Covid-19. Gjatë 24 orëve të fundit janë shënuar dy raste të vdekjes. Sot janë shënuar 465 qytetarë, derisa numri i përgjithshëm i të shënuarve është 161 170. Në total numri i rasteve aktive



ATK-ja: Nga 1 shkurti deklarimi i tatimeve dhe kontributeve do të bëhet online

PRISHTINË, 24 JANAR (ER) - Administrata Tatimore e Kosovës (ATK) ka njoftuar tatimpaguesit se nga 1 shkurti i këtij viti deklarimi i të gjitha tatimeve dhe kontributeve të aplikuara në Kosovë do të bëhet vetëm në mënyrë elektronike përmes sistemit elektronik-EDI. ATK-ja ka bërë me dije se sistemi elektronik-EDI është plotësisht funksional dhe është

vlerësuar lart si nga komuniteti i biznesit ashtu edhe nga palë të tjera të interesit. Sipas ATK-së, deri më tani 98 për qind e të gjithë tatimpaguesve potencialë për të deklaruar tatime dhe kontribute në Kosovë janë duke e deklaruar përmes sistemit elektronik-EDI. “Të gjithë tatimpaguesve, të cilët ende nuk janë regjistruar në sistemin elektronik-EDI, Administrata

Tatimore e Kosovës, u bënë thirrje që të regjistrohen sa më parë dhe ta përdorin këtë sistem për deklarim. ATK-ja që nga data 01 shkurt 2022 do ta ndërpresë mundësinë e shkarkimit të formularëve elektronikë për Tatime dhe Kontribute dhe këto do të mund të deklarohen vetëm përmes sistemit EDI”, ka njoftuar ATK-ja.



Covidi i ka kushtuar 350 miliardë euro ekonomisë gjermane

BERLIN, 24 JANAR - Masat kufizuese me lockdown, problemet me rrjetet e furnizimit dhe rezervimi i klientëve: të gjitha këto kanë çuar në rënien e ndjeshme të koniunkturës, sipas Institutit të Ekonomisë Gjermane (IW). Pasojat e pandemisë së koronavirusit në dy vjetet e fundit i kanë kushtuar 350 miliardë euro ekonomisë gjermane në rendimentin e saj, ka konstatuar Instituti i Ekonomisë Gjermane (IW). Kjo shumë në pjesën më të madhe ka të bëjë me rënien e konsumit, ka llogaritur IW-ja në ditën e shpërthimit të pandemisë në Gjermani. Kësaj i është shtuar edhe pakësimi i investimeve të ndërmarrjeve. Në tre muajt e parë të vitit 2021 janë krijuar humbje të tjera në vlerën 50 miliardë euro, ka thënë IW-ja. “Ripërtëritja ekonomike do të zgjasë me vite”, kanë parashikuar studiuesit e ekonomisë.

Në fillim të pandemisë masat kufizuese deri në lockdown kanë shkaktuar probleme në proceset e prodhimit dhe kanë vështirësuar furnizimet brenda dhe jashtë vendit, kanë shpjeguar ekspertët e IW-së. Humbje janë shkaktuar edhe nga kufizimi i mundësive për konsum dhe rezervimi i klientëve. Bizneset jashtë vendit kanë pësuar rënie. Në tremujorin e dytë të vitit 2020



produkti bruto në vend ka rënë me 11 për qind krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të mëparshëm.

Gjatë ecurisë së pandemisë rënia e numrit të infeksioneve përkohësisht i rriste shpresat për një ripërtëritje të qëndrueshme ekonomike, por me valët e reja të infeksioneve

këto shpresa shuheshin. Në vitin e dytë të koronavirusit, sipas studimit, problemet kryesore u krijuan me rrjetet e furnizimit: mungesa e pjesëve të këmbimit i krijoi vështirësi kryesisht industrisë së prodhimit të automjeteve. Shpenzimet e shtetit në pandemi dhe eksportet të

paktën pjesërisht kanë funksionuar gjatë vitit të dytë të pandemisë, i kanë thënë “DW”-së nga Instituti i Ekonomisë Gjermane. Por parashikohet që edhe gjatë muajve të ardhshëm të ketë humbje. “Varianti i ri ‘Omicron’ i koronavirusit, megjithatë, jep

shkas edhe për shpresë”, ka shpjeguar ekonomisti i IW-së, Michael Gromling: “Nëse sivjet ne hyjmë në fazë endemike, sërish mund të ketë hov në ekonomi. Vitet e ardhshme është i nevojshëm një hop i fuqishëm ekonomik për t’i rikuperuar humbjet”, ka thënë ai.

BE-ja fton Kosovën që ta liberalizojë tregun e energjisë elektrike me pakicë

PRISHTINË, 24 JANAR - Komisioni Evropian (KE) ka kërkuar nga Kosova që ta liberalizojë tregun e energjisë elektrike me pakicë për t’u dhënë konsumatorëve vendorë të drejtën e lirë për ta zgjedhur furnizuesin e tyre. Zëdhënësja e KE-së, Ana Pisonero, ka thënë se Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRR) do të duhej t’i zbatojë zotimet e Kosovës dhe të liberalizohet tregu plotësisht, pra edhe për energjinë elektrike me pakicë.

“Liberalizimi i tregjeve të energjisë elektrike me pakicë e rrit konkurrencën dhe inovacionin, e siguron lirinë e zgjedhjes për konsumatorët dhe i fuqizon ata që të marrin pjesë aktive në tranzicionin e energjisë, përderisa masat zbutëse janë të mundshme për t’i mbrojtur konsumatorët në vështirësi dhe për ta trajtuar varfërinë energjetike. Prandaj, vazhdojmë që të inkurajojmë ZRR-në që ta zbatojë planin për liberalizimin e tregut me

pakicë të energjisë elektrike në Kosovë në përputhje me zotimet e Kosovës lidhur me Paketën e Tretë të Energjisë dhe kërkesat e tjera të Komunitetit të Energjisë”, ka thënë Pisonero për “DTT-Net”.

Thirrje drejtuar Qeverisë së Kosovës për liberalizimin e tregut së fundi kanë pasur edhe partitë opozitare, përderisa institucionet dhe ZRR-ja deri më tash nuk kanë dhënë ndonjë sqarim pse kjo nuk po bëhet.



Mbi efektin e subvencioneve dhe formave të tjera të ndihmës shtetërore



Shkruan: Elton TOTA

Dhënia e ndihmës shtetërore nga qeveritë jepet në mënyra të ndryshme dhe për qëllime të ndryshme. Këto qëllime përfshijnë ndihmën për sektorët industrialë, firmat e veçanta, zhvillimin rajonal, inovacionin, investimet, zhvillimin e tregtisë, zhvillimin e biznesit të vogël dhe sektorë kyç si transporti, bujqësia dhe industri të ndryshme. Shumë prej formave të ndihmës shtetërore mund të jenë shumë të dobishme duke adresuar dështimet e tregut ose duke promovuar barazi ose mundësi më të mëdha.

Një nga format më të zakonshme të ndihmës shtetërore përmes së cilës qeveritë angazhohen për të nxitur zhvillimin apo modernizimin e sektorëve të caktuar të ekonomisë është dhënia e subvencioneve. Subvencionet jepen përmes programeve të caktuara dhe duke u bazuar mbi kritere përkatëse sipas sektorëve të zgjedhur për tu mbështetur financiarisht. Në përgjithësi, ashtu si edhe format e tjera të ndihmës shtetërore edhe fondet e miratuara për tu dhënë përmes subvencioneve kanë për qëllim kryerjen e investimeve për rritjen e konkurrueshmërisë në treg, përmirësimin e teknologjisë, stimulimin dhe rritjen e prodhimit, furnizimin e qëndrueshëm të tregut etj. Në këto raste, masa totale e mbështetjes, masa e përfitimit për ndërmarrje si dhe numri i ndërmarrjeve përfituese miratohet nga dhënësi i ndihmës shtetërore, zakonisht nga

Ministria e Financave dhe pasi të konsultohen organet përkatëse për vlerësimin e ndihmës shtetërore.

A duhet kontrolluar dhënia e subvencioneve në pikëpamje të ndihmës shtetërore?

Në përgjithësi, dhënia e ndihmës shtetërore është e ndaluar, por megjithatë ndihma jepet, por në këtë rast ajo duhet që paraprakisht të njoftohet si dhe të miratohet nga autoritetet e ndihmës shtetërore. Kjo me qëllim që të sigurohet mbrojtja e konkurrencës së drejtë, pra që dhënia e ndihmës shtetërore të mos ndikojë në shtrembërimin e konkurrencës në treg. Në këtë aspekt, edhe për subvencionet shtetërore që jepen në formë mbështetje ose ndihme shtetërore për sektorë të caktuar, dhënia e tyre duhet të jetë e kontrolluar në mënyrë që këto subvencione të shkojnë tek ato ndërmarrje të cilat kanë nevojë për to duke u përputhur kështu me qëllimin për të cilin ato jepen. Në të kundërt, subvencionet ashtu si edhe format e tjera të ndihmës shtetërore (si për shembull: grante dhe pjesëmarrje nga taksat, kreditë të buta, shtyrje të pagesës së taksave, garancitë, lehtësimet tatimore dhe masa të tjera mbështetëse më pak të drejtpërdrejta) mund të kenë efekt negativ në treg duke

ndikuar në shtrembërimin e konkurrencës. Prandaj, organet përkatëse të kontrollit të ndihmës shtetërore duhet që të vlerësojnë ndikimin e efektit të subvencioneve dhe formave të tjera të dhënies së ndihmës duke pasur si qëllim kryesor të tyre mbajtjen hapur të tregjeve.

Çfarë parasheh legjislacioni në fuqi?

Në Kosovë, legjislacioni në fuqi e përcakton qartë kornizën institucionale të kontrollit dhe të mbikëqyrjes së ndihmës shtetërore si dhe detyrimin e dhënësve të ndihmës shtetërore që autoriteteve përkatëse të ndihmës shtetërore t'i ofrojnë informacione në lidhje me ndihmën shtetërore. Sistemi i kontrollit të ndihmës shtetërore përbëhet nga Komisioni i Ndihmës Shtetërore (KNSH) si organ i pavarur vendimmarrës, i ngarkuar me detyrat dhe përgjegjësitë kryesore që kanë të bëjnë me përcaktimin nëse një masë në shqyrtim përbën ndihmë shtetërore, me marrjen e vendimeve mbi pajtueshmërinë, mos-pajtueshmërinë ose pajtueshmërinë e kushtëzuar të ndihmës shtetërore, monitorimin e ndihmës shtetërore ekzistuese, publikimin e listës së zonave të pazhvilluara me qëllim të vendosjes së kufijve maksimal të ndihmës në lidhje me ato zona, fillimin e hetimit zyrtar mbi një masë specifike të ndihmës apo revokimi i ndihmës shtetërore përfshirë përcaktimin e normës së

zbatueshme të interesit në këtë rast.

Në formë të mbështetjes profesionale dhe administrative, KNSH-së i sigurohet ndihmë nga Departamenti i Ndihmës Shtetërore (DNSH) i Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve (MFPT) i cili kryen vlerësimin, kontrollin dhe monitorimin e ndihmës shtetërore. Në të tre këto komponentë DNSH-ja ka një rol të rëndësishëm që mund të përmblihet si në vijim:

- së pari, DNSH-ja kryen vlerësimin mbi pajtueshmërinë e ndihmës individuale dhe të skemave të ndihmës shtetërore me dispozitat ligjore si dhe përgatit raportin e vlerësimin të ndihmës përfshirë edhe propozimet për vendimmarrje për KNSH-në.


- së dyti, kryen kontrollin ex-post të ndihmës si dhe mund të kërkojë revokimin e ndihmës së papajtueshme, dhe nëse ndihma shtetërore është dhënë pa një vendim paraprak të KNSH-së, Departamenti fillon procedurat për kontroll të ndihmës së paligjshme dhe për revokimin e ndihmës shtetërore, dhe;

- së treti, DNSH-ja ka një rol të veçantë edhe në monitorimin e ndihmës shtetërore që konsiston në mbledhjen, përpunimin dhe regjistrimin e të dhënave për ndihmën shtetërore, përfshirë ndihmën shtetërore de minimis me qëllim që të kontrollojë pajtueshmërinë e ndihmës shtetërore ekzistuese me kërkesat ligjore dhe me vendimet e KNSH-së si dhe të siguruar

sigurojë transparencë në fushën e ndihmës shtetërore.

Siç u theksua më lart, roli i autoriteteve zbatuese të ndihmës shtetërore është i përcaktuar në legjislacionin në fuqi për ndihmën shtetërore. Në përgjithësi ligji është në pajtueshmëri me dispozitat e BE-së për ndihmën shtetërore por që ende janë të nevojshme ndryshime në mënyrë që ligji të harmonizohet në tërësi me dispozitat e MSA-së ndërmjet BE-së dhe Kosovës (2016) e cila ndër të tjera parasheh që Kosova duhet të krijojë: një inventar që përmban skemat e ndihmës, një regjistër të ndihmës shtetërore që përmban të gjitha ndihmat (individuale ose skema), si dhe një regjistër të ndihmës de minimis. Po ashtu, ligji për ndihmën shtetërore duhet të përfshijë si kategori ligjore edhe elemente të tjera të nevojshme përfshirë të drejtat, detyrimet dhe përgjegjësitë e KNSH-së dhe DNSH-së që kanë të bëjnë me kontrollin, revokimin apo monitorimin e ndihmës shtetërore. Në këtë kontekst duhet përmendur që është gjithashtu i nevojshëm edhe krijimi i legjislacionit përkatës sekondar. Përmirësimi dhe plotësimi i mëtejshëm i legjislacionit, përveç harmonizimit me acquis të BE-së është i nevojshëm edhe për rritur efektivitetin e organeve të kontrollit të ndihmës së shtetit.

Autori është ekspert ligjor në projektin e BE-së në mbështetje të Autoritetit Kosovitar të Konkurrencës dhe Komisionit të Ndihmës së Shtetit.



Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



QENDRA SPORTIVE
'BUJQËSIA'
TEL: 045/82 82 82

Mediumet ndërkombëtare shkruajnë për suksesin historik të Kiana Kryeziut



PRISHTINË, 24 JANAR - Kualifikimi historik i Kiana Kryeziut në Lojërat Olimpikë ka bërë jehonë edhe në mediet ndërkombëtare. Gjiganti mediatik "The Washington Post" i ka kushtuar një artikull skitares sonë, duke treguar rëndësinë që ka kualifikimi për Kosovën dhe natyrisht për karrierën e saj edhe pse intervista është e realizuar për "Associated Press", një tjetër medium i madh. Gara në sllallomin gjigant në Lojërat Olimpikë të Pekinit do të jetë një hap gjigant për 17-vjeçaren Kiana Kryeziu dhe vendin e saj, Kosovën.

Kryeziu është sportistja e parë nga Kosova në Lojërat Dimërore pasi ka përmbushur standardin kualifikues gjatë garave të zhvilluara në Itali. "Me të vërtetë nuk e prisja që do të ndodhte kaq herët", ka thënë Kryeziu për "Associated Press". "Ishte një nga synimet e mia më të mëdha. Ishte një nga ëndrrat e mia dhe tani gjithçka po bëhet realitet". "Jo se ka qenë e lehtë", deklaroi ajo, me shumë stërvitje të vështira, si dhe gjetjen e parave për një sport të shtrenjtë. Kryeziu mbështetjen e saj

kryesore financiare e ka pasur nga sponsorët, por është mirënjohëse edhe për ndihmën e Federatës së Skitarisë të Kosovës, Komitetin Olimpik dhe Ministrinë e Sportit.

Po aq e rëndësishme, "vetëm një telefonatë larg" ishte mbështetja e babait dhe trajnerit të saj. "Pjesëmarrja e saj në Olimpiadë është arritja më e madhe dhe, kushedi, çdo rezultat i mirë (është i mundur)", potencoi trajneri i saj, Agim Pupovci.

Visar Kryeziu, babai i Kiana Kryeziut, deklaroi se arritja e saj në realizimin e Lojërave Olimpikë "na tronditi ne si dhe gjithë kombin". Kryeziu ka filluar të garojë si skiatore rreth moshës 10 apo 11-vjeçare. "Dhe pastaj bie në dashuri me të", bëri me dije Kryeziu, duke e quajtur atë "pasion dhe lumturi" që atëherë. Babai i saj, i cili është një fotograf për "Associated Press", e pa potencialin. "E pashë që nëse investoja 10 për qind të kohës për të, kthimi ishte 110%", shtoi më tej Visar Kryeziu. "Sekreti pas tij është shumë punë, shumë përkushtim, pasion për sportin dhe përkushtim". Stërvitjet e saj mbaruan buxhetin e familjes, por

mbështetja financiare nga sponsorët e lejoi atë të stërvitej në Austri dhe Itali vitin e kaluar. Ambicia e Kryeziut është që në Pekin të përfundojë jo më shumë se 10 sekonda prapa fituesit. Lojërat Olimpikë fillojnë më 4 shkurt. Adoleshentja ka thënë se qau kur Majlinda Kelmendi (Rio de Zhaneiro 2016), Nora Gjakova dhe Distria Krasniqi (Tokio 2020) fituan medaljet e arta olimpikë në xhudo për Kosovën. Kosova u bë anëtare e Komitetit Olimpik Ndërkombëtar në vitin 2014. Pas luftës në vitet 1998-'99, kur Serbia vrau rreth 13 000 njerëz dhe pas përfundimit të saj, pasi NATO bombardoi Serbinë për ta ndaluar gjenocidin ndaj shqiptarëve etnikë separatistë, Kosova fillimisht u qeveris nga Kombet e Bashkuara dhe në vitin 2008 shpalli pavarësinë. Nuk njihet nga Serbia. Kryeziu është në vitin e fundit të shkollës së mesme. "Të bësh zhonglim me shkollën, sportin, jetën familjare dhe shoqërore është shumë e vështirë", shton më tej ajo, por "duket se kam arritur ta gjej ekuilibrin e përsosur", përfundon intervista e saj për AP.

SHKURT

FC Prishtina vazhdon përgatitjet intensive në Turqi

FC Prishtina vazhdon përgatitjet intensive në Antalya të Turqisë. Skuadra gjatë paradites së sotme e ka kryer stërvitjen e radhës, teksa pasdite është planifikuar nga trajneri Abdulah Ibrakoviq një tjetër seancë përgatitore. Gjendja e futbollistëve është e mirë. Edhe lojtarët Bujar Pllana, Agim Zeka, Drilon Cenaj, Sadam Sulley dhe Adonis Aliu janë përshtatur shumë mirë me grupin. Prishtina të mërkurën (26 janar) e zhvillon ndeshjen miqësore të radhës, me ç'rast do të përballet me skuadrën nga Kazakistani, Atyrau.

Rrahmani dhe Bajrami në formacionin e javës në Serinë A

Amir Rrahmani dhe Nedim Bajrami janë zgjedhur në formacionin e javës të 23-të të Serisë A, pas paraqitjeve brilante në fundjavën që shkoi me skuadrat e tyre. Dyshja shqiptare realizuan nga një gol këtë xhiro. Mbrojtësi i Napolit, Rrahmani, shënoi gol dhe bëri një paraqitje tejet të mirë në fitoren 4-1 ndaj Salernitanas. Ndërsa fantazisti i Empolit, Bajrami, shënoi gol kundër Romës në humbjen 2:4. Reprerentuesi i Kosovës, Rrahmani, është vlerësuar me notën 8.0, ndërsa mesfushori i kombëtares kuqezij me notën 7.9. Rrahmani së bashku me Banin dhe Patricin bëjnë treshen e mbrojtjes, ndërsa Bajrami është vendosur prapa sulmuesve Tammy Abraham dhe Dries Mertens në sistemin 3-4-1-2.

Ish-kapiteni i Cityt lavdëron Brojën: Nuk ka frikë dhe ka cilësi

Armando Broja vazhdon të jetë temë diskutimi në futbollin anglez dhe elozhet për sulmuesin shqiptar nuk kanë fund. Këtë herë vlerësimet kanë ardhur nga një emër shumë i njohur i futbollit britanik e botëror, ish-mbrojtësi Micah Richards. Ky i fundit, kapiteni më i ri në moshë në historinë e Manchester Cityt, pranoi se kishte mbetur i çuditur nga shpërthimi i Brojës dhe i mahnitur nga ajo që ky djalosh po shfaqte. Që para sfidës së Southamptonit ndaj Cityt ai foli me elozhe në studion e "Sky Sports". "Ai ka cilësi. Kur e pashë për herë të parë ai ishte në huazim nga Chelsea, por ka shënuar pesë gola deri tani. Nuk ka frikë, është i fortë, vrapon prapa shpinës së mbrojtësve, mund të mbajë topin dhe është vetëm në moshën 20 vjeçare. Më ka bërë shumë përshtypje, shpesh, kur lojtarët e rinj shkojnë në huazim, sidomos në Premierë Ligë, ata luajnë si zëvendësues dhe atij iu desh pak kohë. Por kur iu shfaq rasti, e mbërtheu atë me të dyja duart. Më bën shumë përshtypje sa herë që e shoh atë duke luajtur", ka thënë Richards. Pas sfidës, ish-mbrojtësi duartrokroi përsëri paraqitjen e sulmuesit shqiptar që krijoi vazhdimisht panik në prapavijën e kampionëve në fuqi. "Ai është vetëm 20-vjeçar. Ai mban linjën e vetëm, ka lojën e kontrollit të topit, është një rrezik i vazhdueshëm duke vrapuar pas mbrojtësve, ka edhe aftësi në ajër gjithashtu. Ai po rritet edhe fizikisht. Po flasim për dy nga qendërmbrojtësit më të mirë në kampionat, Laport dhe Dias dhe ai i bëri të vuajnë, ka prani", ka theksuar ish-mbrojtësi anglez.

KB Peja, organizatore e Final 8 Kupës së Kosovës

PEJË, 24 JANAR - KB Peja do të jetë organizatore e Final 8 Kupës së Kosovës në basketboll. Ky vendim është marrë nga Bordi i Federatës së

Basketbollit të Kosovës (FBK). "Bordi i Federatës së Basketbollit të Kosovës (FBK) e ka miratuar kërkesën e KB Peja për organizimin e Final 8

Kupës së Kosovës në basketboll në datat 09-13 shkurt 2022, pasi skuadra nga Peja i ka plotësuar kushtet e përcaktuara në konkursin për

organizimin e Final 8 Kupës së Kosovës. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e miratimit të tij", thuhet në njoftimin e FBK-së.



LeBron: Po kaloj një nga çastet më të mira të karrierës sime

Los Anxhelos, 24 janar - Pavarësisht prej moshës (37 vjeç), basketbollisti LeBron James po bën një paraqitje të shkëlqyer në parket me Lakersat. Në çdo ndeshje ai

është më i miri në fushë, pavarësisht se rezultatet e skuadrës Lakers këtë sezon në NBA janë me lëvizje. Edhe në ndeshjen e fundit, atë të humbur ndaj Miamit, ai

realizoi 33 pikë. "Nuk kam nevojë të realizoj 30 pikë në ndeshje për të treguar se cili jam. Tashmë njerëzit më njohin. Gjithsesi, mendoj se po kaloj një nga çastet më të mira

të karrierës sime, sidomos në fazën sulmuese. Dhe nuk kam ndër mend të ndalem këtu. Ndihej mjaft mirë dhe po luaj mirë, po luaj thjesht", ka thënë LeBron James.



Prokuroria nis hetimet ndaj Armand Dukës

TIRANË, 24 JANAR - Vetëm një muaj para mbajtjes së zgjedhjeve në Federatën Shqiptare të Futbollit (FSHF), prokuroria e Tiranës i ka filluar hetimet ndaj presidentit të FShF-së, Armand Duka. Siç njoftojnë mediet e Shqipërisë, prokuroria ka nisur hetimet pas referimit që ka bërë Policia e Shtetit dhe mbi Dukën hidhen dy akuza: "Shpërdorim i detyrës" dhe "Vjedhje duke shpërdoruar detyrën". Në fakt, ishte Bashkia e Tiranës, si aksionare e Klubit të Futbollit Tirana, ajo e cila ka kërkuar hetim kombëtar dhe ndërkombëtar për Dukën, të cilën e akuzon se ka bërë shkelje dhe korrupsion që 20 vjet si kryetar i FShF-së. Thuhet se fondet e FIFA-s dhe të UEFA-s të dedikuara për klubet e futbollit të Shqipërisë nuk kanë qarkulluar në mënyrë të rregullt nga Duka. Prokuroria e Tiranës është në fazën fillestare të hetimit, ku po kryen procedurat përkatëse dhe gjithashtu Krimi Ekonomik po i bën hetimet e veta. "Më trego



paratë. Duhet transparencë, ke marrë para për të bërë fushat, ku janë fushat, ku janë pagat e luftës, pse nuk i morën shoqatat e Tiranës? More 2 milionë dollarë, ku shkuan? Zhduken paratë dhe dikush duhet të përgjigjet. Kur shikon që në 20 vjet të kanë ikur bashkëpunëtorët tregon se çfarë lidhshipi je. Ajo që ndodhi në Durrës, ku u falsifikua firma e kryetarit të bashkisë së Shijakut. Si mund të thuash që ëndrrat e çunave në 20 vjet u vendoskan në Shijak", ka akuzuar kryetari i

Bashkisë së Tiranës, Erion Veliaj. Duka planifikon ta kërkojë mandatin e gjashtë në krye të FShF-së përballë kundërkandidatit të tij, gazetarin Dritan Shakohoxha. Ndërkohë që në një reagim të mbrëmjes së djeshme FShF i quajti qesharake akuzat e Veliajt, i cili shkoi edhe më tej duke kërkuar hetim ndërkombëtar për Dukën. "Autogoli mediatic i Bashkisë së Tiranës vërteton ndërhyrjen e dënueshme të saj për t'i prishur zgjedhjet, të denoncuar nga federata. Ne jemi të sigurt se komuniteti i futbollit në vend do ta konsiderojë në pozicion 'jashtë loje' sulmin e Bashkisë së Tiranës ndaj lirisë së zgjedhjeve dhe se nuk do të intimidohet fare nga abuzimet mediatiche të kryetarit të Bashkisë Tiranë. Përkundrazi, qetësisht do të shkojë në votime duke qenë i ndërgjegjshëm për përgjegjësinë të panegociueshme me asgjë", thuhet në reagimin e FShF-së që drejtohet nga Duka.

Fetahu e vlerëson lart organizimin e 'Tryezës së sportit'

PRISHTINË, 24 JANAR - Kryetari i Federatës së Basketbollit të Kosovës (FBK), Arben Fetahu, ka marrë pjesë në ngjarjen dyditore "Tryeza e sportit" që është organizuar nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit e Kosovës në Brezovicë, ku aktorët më të lartë vendorë të komunitetit sportiv kanë diskutuar tema të ndërlidhura me këtë fushë, me qëllim të ndërtimit të vizionit për të ardhmen e zhvillimit të sportit në Kosovë. Organizimi i "Tryezës së sportit" është një vendim më se i qëlluar dhe Federata e Basketbollit e Kosovës e ka mirëpritur ndarjen e informatave dhe ftesën për të ndikuar në planin operativ të këtij viti. "Mendoj se prioritet për gjithë komunitetin e sportit duhet të jetë Strategjia e Sportit. Jemi të

vetëdijshëm se procedura është e gjatë dhe e mundimshme, mirëpo për këtë arsye duhet të reagojmë sa më shpejt", ka thënë Arben Fetahu për faqen zyrtare të FBK-së në lidhje me pjesëmarrjen dhe përfaqësimin e Federatës së Basketbollit të Kosovës në "Tryezën e sportit". Sipas MKRS-së, në këto diskutime u arritën disa përfundime dhe pajtueshmëri, të cilat do të ndihmojnë në orientimin e qeverisë dhe komunitetit të gjerë sportiv drejt zhvillimit të mëtejshëm të sportit në vend. Në përmbajtje të tryezës dyditore mori pjesë edhe kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, për ta ritheksuar vëmendjen dhe dedikimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës për fushën e sportit.



Kryeministri, ndër të tjera, foli për rëndësinë e masivizimit dhe shkëlqimit në sport: "E para do ta shndërroj sportin në kulturë të shoqërisë, me ndikim në shëndetin publik. Ndërsa e dyta, do ta bëjë diplomacinë sportive të suksesshme përmes të arriturave të larta në arenën ndërkombëtare".

SHKURT

Medvedevi mposhti Maksim Kresin, arrin në çerekfinale

Në Melburn të Australisë po zhvillohen sfidat e fundit të raundit të katërt të Grand Slam-it "Australian Open", ku nuk kanë munguar surprizat në fushë. Tensitja rumune Simona Halep, ish-numri 1 në botë, u mund nga francezja Alize Cornet me rezultat 1-2 në sete (6-4, 3-6, 6-4). Një rezultat surprizë, pasi eliminohet një nga favoritët kryesorë. Në çerekfinale shkon edhe tenistja amerikane Danielle Kollins, që mundi 2-1 me përmbysje belgen Elize Mertens (4-6, 6-4, 6-4). Te meshkujt spikat fitorja e tenistit rus Daniil Medvedev, numri 2 në botë dhe favoriti kryesor. Ai mposhti 3-1 amerikanin Maksim Kresi (6-2, 7-6, 6-7, 7-5), në një ndeshje me rivalitet. Një biletë për në çerekfinale siguroi edhe kanadezi Felix Auger-Aliassime, që mundi 3-1 (2-6, 7-6, 6-2, 7-6) kroatin Marin Čiliç.

Ramosi: Shpresoj të shënoj edhe shumë gola të tjerë

Sergio Ramos ka arritur ta shënojë golin e parë me PSG-në në fitoren 4-0 kundër Reims në "Parc des Princes". Ish-mbrojtësi i Real Madridit realizoi golin e dytë të ekipit të tij pas një insistimi në zonën kundërshtare, duke shënuar kështu edhe golin e tij të parë që kur është transferuar në Paris. "Jam i lumtur për golin tim të parë me PSG-në. Shpresoj të shënoj edhe shumë gola të tjerë. Kam tre javë që stërvitem me grupin. E rëndësishme është ta kap ritmin e shokëve, të vazhdoj të përmirësohem fizikisht dhe të vendos në fushë versionin më të mirë të vetes. Përshtatja ime këtu ka qenë e vështirë në fillim. Kam jetuar shumë vite në Madrid, por tani ndihem më mirë në Paris", ka deklaruar Ramos.

Presidenti i Bayernit: Duam që Neueri dhe Lewandowski ta mbyllin karrierën te ne

Në Bayern Munchen po diskutohet prej ditësh për rinovimin e Niklas Sule, por edhe për raste të tjera "të mprehta". Presidenti Herbert Hainer foli për "Sport Bild" në lidhje me këtë: "Ne bëmë një ofertë, tani i takon atij të vendosë nëse do ta pranojë apo jo. Natyrisht, ne do t'i japim atij një periudhë kohore për përgjigjen, sepse pastaj duhet të veprojmë në përputhje me rrethanat". Numri një i Bayernit foli edhe për rinovimin me kapitenin Manuel Neuer. "Unë besoj fuqimisht se Manuel do ta mbyllë karrierën e tij te Bayern Munich. Ai me siguri mund të luajë edhe për disa vjet në nivele të larta. Për mua është ende portieri më i mirë në botë dhe do të isha i lumtur ta njoftoja zgjerimin e marrëveshjes", ka thënë Hainer, duke shtuar: "Drejtori ynë sportiv është në kontakt të vazhdueshëm me lojtarët. Kemi ende pak kohë në këtë rast, Lewandowski ka kontratë deri në qershor të vitit 2023. Siç thashë, do të isha i lumtur nëse ai do ta mbyllte karrierën me ne".

Ancelotti: Ishte ndeshje e humbur, por falë këmbënguljes morëm një pikë

Trajneri i Realit, Carlo Ancelotti, ka analizuar ndeshjen kundër Elches, në të cilin skuadra e tij nuk ka shkuar më shumë se barazimi 2-2. Madje Reali ka rrezikuar humbjen, por ka qenë Militao

në fund që i ka dhënë një pikë. "Në pjesën e parë na kanë shënuar me një gjuajtje në portë. Në golin e dytë të tyre duhet të ishim më kompaktë. Mendoj se detajet na kanë kushtuar dy pikë në këtë

takim. Nuk jemi të kënaqur natyrisht, por duhet të analizojmë me hollësi këtë barazim, sepse tani nis periudha më e rëndësishme e sezonit. Kjo ndeshje ishte e humbur. Kemi shpërdoruar

raste pa fund dhe zakonisht ndodh që këto ndeshje i humb. Por, falë këmbënguljes së lojtarëve, ia kemi dalë të marrim një pikë", ka thënë Ancelotti. "Ndodh edhe kështu. Shumë gjëra varen dhe

nga karakteristikat e lojtarëve që kemi në sulm. Me largimin e Benzemasë nuk kishim një pykë në zonë. Jo më kot golin e dytë e shënoi Militao, gjuajtësi më i mirë me kokë që kemi në ekip", ka shtuar Ancelotti.



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria-Vlada-Government

Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë
Ministarstvo Industrije, Preduzetništva i Trgovine - Ministry of Industry, Entrepreneurship and Trade
Agjencia për Investime dhe Përkrahjen e Ndërmarrjeve në Kosovë (KIESA)
Kosovo Investment and Enterprise Support Agency (KIESA)
Agjencia za Investicije i Podršku Preduzeča na Kosovu (KIESA)

Me qëllim të promovimit të kompanive prodhuese të kosovare në gjetjen e tregjeve të huaja për eksport, Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë përmes Agjencisë për Investime dhe Përkrahjen e Ndërmarrjeve në Kosovë (KIESA) shpallë:

Thirrje publike për aplikim për pjesëmarrje në shtandin shtetëror të Kosovës në panairin e produkteve ushqimore dhe pijeve IFE (International Food & Drink Event) në Londër të Anglisë më 21-23 mars 2022

Paraqitja shtetërore organizohet nga Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë (MINT), përkatësisht Agjencia për Investime dhe Përkrahjen e Ndërmarrjeve në Kosovë KIESA, e cila mbulon shpenzimet e hapësirës ekspozuese, ndërtimin e shtandit, regjistrimin e tetë (8) subjekteve pjesëmarrëse, shpenzimet e energjisë elektrike, pastrimin ditor, etj., ndërsa shpenzimet e udhëtimit, akomodimit, ushqimit, dërgimit të materialeve promovuese, etj. të subjekteve pjesëmarrëse do të merren përsipër nga vet subjektet pjesëmarrëse.

Ju lutem vini re se vetëm shprehjet e interesimit të dërguara deri më datë 11.02.2022 dhe vetëm aplikacionet e plotësuar tërësisht mund të konsiderohen për vlerësim.

- Për të aplikuar duhet dorëzuar:
 - Aplikacionin e plotësuar më të dhënat bazike të subjektit aplikues; dhe
 - Dokumentet e kërkuara.
- Dokumentet e domosdoshme për aplikim:
 - Dëshminë që subjekti aplikues është i regjistruar në Republikën e Kosovës;
 - Dëshminë e xhirrologarisë aktive në njërin prej bankave të licencuara nga Banka Qendrore e Kosovës;
 - Kopjen e letërnjoftimit të personit të autorizuar të subjektit aplikues;
 - Vërtetimin nga Gjykata që dëshmon që personi i autorizuar i subjektit nuk është nën hetime (kërkohet origjinali, jo me i vjetër se 30 ditë).
 - Deklaratën nën betim;
 - Vërtetimin e qarkullimit vjetor të subjektit aplikues për vitin fiskal 2020 nga Administrata Tatimore e Kosovës; dhe
 - Vërtetimin tatimor të subjektit aplikues për obligimet e kryera ndaj Administratës Tatimore të Kosovës, jo më e vjetër se gjashtë (6) muaj.

Ju lutem vini re se në mungesë të cilitdo dokument të kërkuar në listën e mësipërme aplikacioni i subjektit aplikues do të diskualifikohet dhe nuk do të shqyrtohet tutje për kriteret e veçanta të listuara më poshtë.

- Tetë (8) subjektet pjesëmarrëse do të përzgjidhen sipas kriterëve të veçanta në vijim dhe rangimit të pikëve:
 - Produktet që subjekti aplikues do të ju ofrojë blerësve potencial në panair, maksimum dhjetë (10) pikë: një (1) pikë për një (1) produkt, tre (3) pikë për dy produkte, pesë (5) pikë për tri (3) produkte, shtatë (7) pikë për katër (4) produkte dhe dhjetë (10) pikë për pesë (5) e më shumë produkte;
 - Njohuria e gjuhëve të huaja dhe aftësi prezantuese të përfaqësuesve të subjektit aplikues, maksimum dhjetë (10) pikë kumulative: gjuha Angleze pesë (5) pikë, gjuha Gjermane katër (4) pikë dhe gjuhët tjera një (1) pikë;
 - Materiale promovuese të subjektit aplikues në gjuhët e huaja, maksimum dhjetë (10) pikë kumulative: në gjuhën Angleze katër (4) pikë, në gjuhën Gjermane katër (4) pikë dhe dy (2) pikë në gjuhët tjera evropiane;
 - Shtetet ku janë eksportuar produktet e subjektit aplikues gjatë viteve 2020 dhe 2021, maksimum dhjetë (10) pikë kumulative: shtetet anëtare të BE-së pesë (5) pikë, shtetet e Ballkanit Perëndimor që nuk janë anëtare të BE-së (Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina, Serbia, Mali i Zi dhe Maqedonia) tri (3) pikë dhe tregjet e tjera dy (2) pikë;
 - Certifikimi ndërkombëtar i subjektit aplikues, maksimum pesë (5) pikë kumulative: HACCP dy (2) pikë, ISO 22000 dy (2) pikë dhe certifikim tjetër relevant një (1) pikë;
 - Paraqitja e subjektit aplikues në panair tri (3) vitet e fundit, maksimum pesë (5) pikë: një (1) panair një (1) pikë, dy (2) panair dy (2) pikë, tri (3) panair tri (3) pikë, katër (4) panair katër (4) pikë dhe pesë (5) e më shumë panair pesë (5) pikë; dhe
 - Qarkullimi vjetor i subjektit aplikues gjatë vitit fiskal 2021, maksimumi dhjetë (10) pikë: nga zero deri në 500.000 euro katër (4) pikë; nga 500.001 deri në 1.000.000 euro tetë (8) pikë dhe mbi 1.000.000 euro dhjetë (10) pikë;

Më 08.02.2022, në ora 14:00, në sallën e takimeve të KIESA-s, zyrtarët e KIESA-s do të përgjigjen pyetjeve lidhur me organizimin e panairit dhe për mbështetjen e kompanive për pjesëmarrje në këtë panair. Subjektet që kanë nevojë për asistencë për plotësimin e këtij formulari, këshillohen gjithashtu të marrin pjesë në këtë takim.

Subjektet që dëshirojnë të aplikojnë për të marrë pjesë në panair duhet të shprehin interesimin e tyre duke plotësuar aplikacionin dhe ta dërgojnë atë më së largu deri më 11.02.2022 në zyrën e Arkivit të Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, Rr. "Arbënor e Astrit Dehari" nr. 12, 10000, Prishtinë, Republika e Kosovës.

Në momentin e aplikimit subjekti pranon të gjitha përgjegjësitë, obligimet, kriteret dhe detyrat e parapara me legjislacionin në fuqi dhe kriteret e veçanta të parapara në këtë thirrje publike.

Informimi dhe pyetësi për shprehje të interesit mund të merren në KIESA-MINT apo të shkarkohen nga faqet e internetit mint.rks-gov.net dhe kiesa.rks-gov.net apo në e-mail adresën export.kiesa@rks-gov.net.



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria-Vlada-Government

Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë
Ministarstvo Industrije, Preduzetništva i Trgovine - Ministry of Industry, Entrepreneurship and Trade
Agjencia për Investime dhe Përkrahjen e Ndërmarrjeve në Kosovë (KIESA)
Kosovo Investment and Enterprise Support Agency (KIESA)
Agjencia za Investicije i Podršku Preduzeča na Kosovu (KIESA)

U cilju promoviranja proizvođačkih kompanija na Kosovu u pronalaznju stranih tržišta za izvoz, Ministarstvo Trgovine i Industrije preko Agencije za Investicije i Podršku Preduzećima na Kosovu (KIESA) objavljuje:

Javni poziv za apliciranje za učešće na državnom štandu Kosova na sajmu prehrambenih proizvoda IFE (International Food & Drink Event) u Londonu Engleska od 21 - 23 mart 2022

Državna prezentacija se organizuje od strane Ministarstva Trgovine i Industrije, odnosno Kosovske Agencije za Investicije i Podršku Preduzećima KIESA koja pokriva troškove izložbenog prostora, izgradnju štanda, registraciju osam (8) učesnika, troškove električne energije, svakodnevno čišćenje, itd., dok će troškovi putovanja, smještaja, hrane, isporuke promotivnog materijala itd. subjekata koji učestvuju, biti preduzeti od samih učesnika.

Molimo obratite pažnju da se samo izražena interesovanja posla do 11.02.2022 i samo u potpunosti popunjene aplikacije se mogu uzeti u obzir za ocenjivanje.

- Da biste aplicirali treba dostaviti:
 - Aplikaciju popunjenu osnovnim podacima subjekta koji aplicira; i
 - Potrebne dokumente.
- Potrebni dokumenti za apliciranje:
 - Dokaz da je aplikant registrovan u Republici Kosovo;
 - Dokaz o aktivnom računu u jednoj od banaka licencirana od strane Centralne Banke Kosova;
 - Kopija lične karte ovlašćenog lica aplikanta;
 - Uverenje Suda da ovlašćeno lice subjekta nije pod istragom (potreban je original, ne stariji od 30 dana);
 - Izjava pod zakletvom;
 - Potvrda godišnjeg prometa aplikanta za fiskalnu godinu 2020 od strane Poreske Administracije Kosova; i
 - Poresko uverenje aplikanta o izvršenim obavezama prema Poreskoj Administraciji Kosova, ne stariji od šest (6) meseci.

Molimo obratite pažnju da u nedostatku bilo kog dokumenta koji se zahteva na gore navedenoj listi, aplikacija aplikanta će biti diskvalifikovana i neće se dalje razmatrati za specifične kriterijume navedene u nastavku.

- Osam (8) učesnika bit će odabrani prema sledećim specifičnim kriterijumima i tačkama rangiranja:
 - Proizvode koje će aplikant pružiti potencijalnim kupcima na sajmu, maksimalno deset (10) poena: jedan (1) poen za jedan (1) proizvod, tri (3) poena za dva proizvoda, pet (5) poena za tri (3) proizvoda, sedam (7) poena za četiri (4) proizvoda i deset (10) poena za pet (5) ili više proizvoda;
 - Poznavanje stranih jezika i veština prezentacije predstavnika subjekta koji učestvuju na sajmu, maksimalno deset (10) kumulativnih poena: Engleski jezik pet (5) poena, Nemački jezik četiri (4) poena i drugi jezici jedan (1) poen;
 - Promotivni materijali na stranim jezicima, maksimalno deset (10) kumulativnih poena: na Engleskom jeziku četiri (4) poena, na Nemačkom jeziku četiri (4) poena i dva (2) poena na drugim Evropskim jezicima;
 - Države u kojima su proizvodi aplikanta izvezeni tokom 2020 i 2021, maksimalno deset (10) kumulativnih poena: države članice EU pet (5) poena, države Zapadnog Balkana koje nisu članice EU (Albanija, Bosna i Hercegovina, Srbija, Crna Gora i Makedonija) tri (3) poena i druga tržišta dva (2) poena;
 - Međunarodna sertifikacija aplikanta, maksimalno pet (5) kumulativnih poena: HACCP dva (2) poena, ISO 22000 dva (2) poena i druge relevantne sertifikacije jedan (1) poen;
 - Prezentacija aplikanta na sajmovima u poslednje tri (3) godine, maksimalno pet (5) poena: jedan sajam jedan (1) poen, dva (2) sajmovi dva (2) poena, tri (3) sajmovi tri (3) poena, četiri (4) sajmovi četiri (4) poena i pet (5) i više sajmovi pet (5) poena;
 - Godišnji promet aplikanta tokom fiskalne godine 2021, maksimalno deset (10) poena: od nule do 500.000 evra četiri (4) poena; od 500.001 do 1.000.000 evra osam (8) poena i preko 1.000.000 evra deset (10) poena;

Dana 08.02.2022, u 14:00 časova, u sali za sastanke KIESA, službenici KIESA će odgovoriti na pitanja o sajamskoj organizaciji i podršci kompanijama za učešće na ovom sajmu. Subjektima kojima je potrebna asistencija u popunjavanju ovog obrasca savetuje se da takođe prisustvuju ovom sastanku.

Subjekti koji žele da apliciraju za učešće na sajmu treba da izraze svoje interesovanje popunjavanjem aplikacije i poslati najkasnije do 11.02.2022 u kancelariji Arhive Ministarstvo Industrije, Preduzetništva i Trgovine, Ulica: Arbënor e Astrit Dehari" no. 12, Priština, 10000, Republika Kosovo.

U trenutku apliciranja, subjekat prihvata sve odgovornosti, obaveze, kriterije i dužnosti predviđene važećim zakonima i posebnim kriterijumima predviđenim u ovom javnom pozivu.

Informacije i upitnik za izražavanje interesovanja mogu se dobiti na KIESA-MINT ili preuzeti sa veb stranice mint.rks-gov.net i kiesa.rks-gov.net ili na e-mail adresi export.kiesa@rks-gov.net.



**MILLENNIUM
FOUNDATION
KOSOVO**

SPECIFIC PROCUREMENT NOTICE (SPN)

Country	Kosovo
Project Name	Threshold Program
Procurement Title	Contract for the Construction of Apartment Building Efficiency Retrofits (AER) – Gjakova
Procurement Ref. Number	RFQ / 2022/No. 004
Type of Procurement	Works
Employer	Millennium Foundation of Kosovo (MFK)
Publication Date	24 January 2022
Submission Deadline	14 February 2022; 14:00 pm (Kosovo Time)

The Millennium Foundation Kosovo has received financing from the Millennium Challenge Corporation toward the cost of the “Threshold Program agreement”, and intends to apply part of the proceeds toward payments under the contract for the Contract for the Construction of Apartment Building Efficiency Retrofits (AER) – South Mitrovica.

MCC’s funding is appropriated by the U.S. Congress and obligated to the threshold up-front, with no incremental or partial funding. So, when a contract is signed with an MCA Entity, money is already available to the MCA Entity and, for most contracts, invoices are paid directly to Contractors/Consultants/Suppliers by the US Treasury.

MFK now *bids* from eligible *bidders* for the Works Requirements.

Bidding will be conducted through the *Shopping* procedures as specified in the MCC Program Procurement Guidelines (PPG), and is open to all eligible bidders or consultants as defined in the PPG.

A complete set of Request for Quotation (RFQ) documents including any clarifications, notices and/or addendums may be obtained by interested eligible bidders through the following website (Eventual clarifications or any changes to the RFQ document shall be published at the latest 3 days before the submission deadline on the link provided below):

<https://millenniumkosovo.org/procurement/procurement-of-contract-for-the-construction-of-apartment-building-efficiency-retrofits-aer-gjakova-rfq-2022-004>

Bidders interested in submitting bids should register their interest by sending a completed registration, with the reference and subject of the RFQ to the Procurement manager at procurement@millenniumkosovo.org, giving full contact details of the bidder.

Please note that only electronic applications submitted via the File Request Link (dropbox link) shall be accepted. Submissions by hard copy or by email are not acceptable and shall culminate in bids rejection. The File link for submission of bids is included in the RFQ document.

Bids shall be submitted ONLY to the file request link provided in RFQ documents no later than 14 February 2022 at 14:00 (Kosovo Time). Only electronic submission will be permitted. Late applications will be rejected.

Contact Information:

The address(es) referred to above is (are):	Str. “Migjeni” no. 21 (ex-Bank of Ljubljana, floor IX), Postal Code:10000 Prishtina, Kosovo
Attn:	Arton Çitaku MFK Procurement Manager Str. “Migjeni” no. 21 (ex-Bank of Ljubljana, floor IX), Postal Code:10000 Prishtina, Kosovo
Tel:	00 383 38 752 110
E-mail:	procurement@millenniumkosovo.org
Website:	https://millenniumkosovo.org

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 03/L-214 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Neni 20, pika 2 dhe 4, Kompania “ Newco Mirusha” L.L.C. Suharekë, në bashkëpunim me Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapsinor dhe Infrastrukturës, organizojnë:

DEBAT PUBLIK

Për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis , të fabrikës për prodhimin e shtyllave të betonit në Volljakë, Klinë.

Njoftohet publiku i interesuar se më datën 15.02.2022 në ora 10:00 në hapësiratë e Restorantit Ermali, në Volljakë, komuna e Klinës, kilometri i 7 ne magjistralen Klinë - Gjakovë do të organizohet debat publik nga Kompania “ Newco Mirusha” L.L.C. Suharekë, në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapsinor dhe Infrastrukturës.

Debati publik do të organizohet për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis,të fabrikës për prodhimin e shtyllave të betonit në Volljakë, Klinë.

Debati Publik do të organizohet edhe në mënyrë virtuale në platformën ZOOM

<https://us02web.zoom.us/j/88168580881?pwd=YTNGUWVqZb0tKTTVvTDNTZitKZnZ0UT09>

Meeting ID: 881 6858 0881

Passcode: 459865

Në linkun e mëposhtëm mund të gjeni raportin e VNM-së për kompaninë “ Newco Mirusha” L.L.C. Suharekë, të fabrikës për prodhimin e shtyllave të betonit në Volljakë, Klinë.

https://mmphi.rks-gov.net/dokumentet_dhe_publicimet/279/publicimet

Pjesëmarrja e juaj na ndihmon ne implementimin e projektit.

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se “GONA” SH.P.K. Pronar Mejreme Isufi, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb. 810129686 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditorë - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa “GONA” D.O.O. Mejreme Isufi donelo odluku o prestani rada sa nrb. 810129686 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

All clients are to be informed that the “GONA” L.L.C. Mejreme Isufi, has come to the decision to quit its business: 810129686 the company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgage – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.

Lume's Details

Estetik & Depilim

044 900 978 | 045 681 898

Sallon Depilimi Lume's Details

lumesdetails

Mbrapa Teatrit, 4 Shullat, Rr. Bajram Kelmendi

Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë

www.facebook.com/gjejpuneshpejte

RESTAURANT

SWISS

TAVERNA

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553

PRISHTINË

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Bashkim Kurtaj shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - V dhe VI - IX shfmu " Leke Dugagjini " Prizren.
- Ardijan Paqarizi shpall te pavlefshme dëftesat, diplomën , certifikatën shmlt "11 Marsi " Prizren.
- Arjan Hogjaj shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - VIII shfmu " Naim Frasheri " Vlashnje.
- Fatjon Micaj shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - IX shfmu " Abdyl Frasheri " Prizren.
- Mjellma Nagavci nga Gjakova, shpall të pavlefshme diplomën e fakultetit të Edukimit të lëshuar nga ish-SHLP "Bajram Curri" tash Universiteti "Fehmi Agani", Gjakovë.
- Lirim Dajaku shpalle te pavlefshme diplomën e ShMLT "Anton Ceta"
- Lëshoj banës me qira në lagjen "Dardania" në Prishtinë. Banesa ka 50 m2, me inventar të kompletuar, banesa ka kuzhinë me sallon, teras, banjo një dhomë gjumi, shpajz dhe korridor, banesa lëshohet për një qift ose për dy vajza. Tel: 044171328.
- Lëshoj shtëpinë me qira në lagjen Velania, pa pagesë sepse shtëpia ka nevojë për përkujdesje ndërsa shpenzimet mujore ti bëjë vetë banuesi si: ujë rrym bërlllok, Tel: 044-608-626.
- Lëshoj banës me qira për student apo familjar në lagjen "Mati 1" Rr. "Muharrem Fejza", banesa është 70 m2 dhe i plotëson të gjitha kushtet, kati dytë ndërtim i ri tel: 044-686-900.
- Lëshoj banesë me qira, banesa është ndërtim i ri dhe gjendet në lagjen "Mati 1" rruga "Muharrem Fejza" Prishtinë. Tel: 044-686-900.
- Lëshoj banesë me qira në lagjen "Mati 1" përball "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m2, kati dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 Euro. Tel: 044-185-233.
- Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpian kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.
- Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.
- Urgjentisht kërkoj një banesë me qira ne Prishtine. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188
- Lëshoj lokalin më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit:049-392-275
- Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanet me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139
- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.
- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes , sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.
- Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.
- Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.
- Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.
- Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.
- Lëshoj banesën e re me qira në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 Euro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049/44-888-801 (viber)
- Lëshoj banesë me qira, penthouse. Banesa gjendet te Rrethi i Veternikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m2, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë nume të tel: 049-440-466.



ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Caseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

